

MENAXHER MARKETINGU – KFC Maqedonia e Veriut

Për KFC

Të gjithë e duam pulën, por ajo që vërtet na dallon nga të tjerët janë njerëzit tanë me ide të shkëlqyera, të cilët qëndrojnë pas suksesit të KFC-së.

Prandaj, kërkojmë kandidatë të kualifikuar që ndajnë vizionin, vlerat dhe përkushtimin tonë ndaj njerëzve tanë, si dhe ndaj ofrimit të një shërbimi të nivelit të lartë për mysafirët tanë.

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

- Përgatit dhe zbaton kalendarin e marketingut;
- Krijon dhe zbaton strategjinë e markës në përputhje me udhëzimet e franchisorit;
- Menaxhon bashkëpunimin dhe marrëdhëniet me agjencitë mediatike;
- Menaxhon bashkëpunimin me agjencinë ekzistuese të marketingut dhe merr pjesë në zhvillimin e mëtejshëm të markës;
- Përgatit parashikime për objektivat e shitjeve;
- Krijon strategji marketingu për rritjen e të ardhurave;
- Zbaton aktivitete lokale të marketingut;
- Monitoron rezultatet përmes treguesve KPI;
- Punon në përputhje me SOP (Procedurat Standarde Operative);
- Krijon dhe zbaton strategjinë PR të markës në përputhje me udhëzimet dhe standardet e markës;
- Zbaton dhe respekton të gjitha rregullat, ligjet dhe direktivat në fuqi në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kë kërkojmë?

Do të jeni Menaxher me mundësi për rritje dhe zhvillim të mëtejshëm brenda kompanisë. Si pjesë e ekipit menaxherial, do të jetë e nevojshme të mbështesni vazhdimisht njerëzit me të cilët punoni dhe t'i udhëhiqni ata me përkushtim drejt realizimit të vizionit të kompanisë.

Si Menaxher i Marketingut, do t'i raportoni drejtpërdrejt Drejtorit Ekzekutiv dhe do të keni një rol kyç në zhvillimin dhe rritjen e kompanisë.

Kjo pozitë gjithashtu kërkon:

- Diplomë Bachelor ose Master në fushën e marketingut, biznesit ose një fushë të ngjashme;
- Të paktën 2 vite përvojë pune në një pozitë menaxheriale në marketing ose në një pozitë të lidhur me këtë fushë;
- Aftësi të shkëlqyera strategjike, organizative dhe vendimmarrëse;
- Aftësi të shkëlqyera komunikuese;
- Aftësi të shkëlqyera ndërpersonale dhe empati;
- Aftësi të mira analitike dhe aftësi për të punuar me integritet, profesionalizëm dhe konfidencialitet;
- Njohuri të avancuara të programeve bazë kompjuterike, përfshirë aplikacionet MS Office;
- Njerëz me ide të shkëlqyera që duan të buzëqeshin.

Çfarë ju ofrojmë?

- Trajnime profesionale brenda dhe jashtë vendit;
- Ushqim ditor falas me produktet tona KFC, në vlerë deri në **150 EUR në muaj**;
- **20% zbritje** për çdo blerje shtesë;
- Ushqim dhe pije falas në zyrë;
- Automjet zyrtar në dispozicion gjatë orarit të punës;
- Pajisje elektronike për punë (telefon, laptop dhe pajisje të tjera);
- Kompensim për pushimin vjetor (**K-15**), në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.